

Themelim i Institutit Zviceran të Studimeve Shqiptare (ISEAL)

Shkruar nga KosPress

E Mërkurë, 21 Prill 2010 16:53



ISEAL-i ka për qëllim zhvillimin dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet Zvicrës dhe shqiptarëve, të ndihmojë integrimin e shqiptarëve në Zvicër, të bëhet një partner i njohur prej autoriteteteve të Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, për të gjitha çështjet në lidhje me komunitetin shqiptar të Zvicrës, si dhe të shërbejë si pikë referimi për vende të tjera ose organizata ndërkombëtare që interesohen për çështjet shqiptare.

Fondacioni ISEAL ndjek qëllime me vlerë publike, duke përjashtuar çdo qëllim përfitimi.

Sektorët e aktiviteteve: Për t'i arritur qëllimet e tij, ISEAL-i do të shfrytëzojë një Institut Shkencor me 4 sektorët e mëposhtëm:

Kërkime: Të bëjë kërkime në fusha të ndryshme, si: formimi, integrimi, politika, gjuhësia, sociologjia, ekonomia, kultura, historia, gjeografia dhe teologjia.

Botime: Të botojë vepra periodike, libra, broshura dhe butelina të tjera (në gjermanisht, frëngjisht, italisht, shqip etj.).

Mësimdhënie: Të japë një mësimdhënie e cila do të përfundojë me formime të vërtetuara dhe/ose me kredi ECTS (European Credit Transfer and Accumulation System).

Qendër dokumentimi: Në bashkëpunim me universitetet, shkollat e larta, bibliotekat dhe autoritetet e Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë si dhe me institute të ndryshme private apo publike.

Fillimi i aktiviteteve: Nga muaji nëntor 2010, një ekip i vogël, i shoqëruar nga afër nga Këshilli i Fondacioni ISEAL, do të vërë në veprim vendosjen e strukturave të ISEAL-it.

Anëtarët themelues të ISEAL-it

Zonja Barbara BURRI-SHARANI, psikologe, Zonja Magaly HANSELMANN, koordinatore e kantonit Vaud në fushën e integrimit të të huajve dhe parandalimit të racizmit, Prof. Dr. Doris JAKUBEC, ish drejtoreshë e Qendrës së Kërkimeve Letrare të Zvicrës Franceze, M. Daniel ABIMI, gazetar, M. Francis COUSIN, ish-ambasador, M. Driton KAJTAZI, autor dhe mësimdhënës, Prof. Dr. Peter KNOEPFEL, Profesor titullar i katedrës së politikave publike, afatgjata e zhvillimore pranë IDHEAP-it, Dr. Régis MARION-VEYRON, mjek-psikiatër, M. Bruno MIGLIARINI, kuadër bankar, M. Victor RUFFY, gjeograf, ish-kryetar i Parlamentit Zviceran, Prof. Dr. Basil SCHADER, profesor në SHLP në Cyrih.

Konteksti shoqëror

mendi said:

 Pershendetje, me vjen mire per mundin tuaj dhe organizimin tuaj per kete pune te madhe, se nuk eshte aq e lehte per ti arit keto dhe ju urou shum sukses. Un jam preofesor i diplomuar i sociologjisë dhe ndjek tash studimet Master Shkencat politike ne drejtimin Diplomaci dhe Mardhenie nderkombetare. Dhe si jane mundesit e mia te inkudrohem ne kete institut, jetoi ne Basel.film

29 October, 2010

Bislim Fetahaj said:

 U gezova shume se paska dikush prej shqiptareve qe po mendojka e po punojka per se mbari! Shendet e suksese!

17 June, 2010

Ibrahim said:

 Se pari ju uroj per kete projket kaq te rendesishem. Me vemendje e lexova kete komunikate per hapjen e Institutit ISEAL.

Desha te pyes se a ka ndonje menyre qe edhe une nga Kosova te inkudrohen ne kete Institut, per me shume mund ta le email dhe nr. tim personal te telefonit.

Ju faliminderit per mirekuptim.

Mireupafshum!

21 April, 2010

Sali Fejza said:

 Driton dhe ju stafi i ketij Institutit ju prift e mbara per kete pune te shkelqyeshme. Po ashtu ju faliminderit Kospress per keto informata kaq te bukura per kulturen shqiptare ne pergjithesi. Suksese...

21 April, 2010

Fjolla Hoxhaj said:

 Nje pune e pashembullt

21 April, 2010

Arta said:

 Ky Institut, pra ISEAL-i paska nje qëllim shume te mire, pra siq e lexova qellimi i tij eshte zhvillimin dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet Zvicrës dhe shqiptarëve, të ndihmojë integrimin e shqiptarëve në Zvicër, të bëhet një partner i njohur prej autoriteteteve të Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, për të gjitha çështjet në lidhje me komunitetin shqiptar të Zvicrës, si dhe të shërbejë si pikë referimi për vende të tjera ose organizata ndërkombëtare që interesohen për çështjet shqiptare.

Kjo eshte nje pune e papershkrueshme, vetem pune qellimi i arritjes se sukseseve eshte i sigurte.

Te lumte Driton Kajtazi

21 April, 2010

Gani Isufaj said:

 Qenkeni nje staf i komplektuar. Puna ju shkoft siq eshte ma se miri

21 April, 2010

Agim Berisha said:

 Ju lumte per kete Institut kaq te rendesishem per kulturen shqiptare. Nje gje me vjen keq qe ne Kosove pothuajse asgje nuk eshte duke u bere ne Institutet tonë, e me vjen mire qe nje Institut i ketij kllloji qe eshte hapur ne Zvicerr.

Ju lumte e pune te sukseseshme